Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0683

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimi-Paneste Individuale duke vendosur sipas ankesës së OE N.T.P.GRESA - COMMERCE , kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 14/10/2026, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e N.T.P.GRESA - COMMERCE me nr. 2026/0683 , e datës 07/09/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet", me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.

2. Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS, lejohet te vazhdoje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet", me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.05.2026, KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me Furnizim me dru dhe pelet me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00 €.

Me 25.08.2026, OE N.T.P.GRESA - COMMERCE , ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 28.08.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07.09.2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.P.GRESA - COMMERCE , me nr. 2026/0683 lidhur me aktivitetin Furnizim me dru dhe pelet me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.P.GRESA - COMMERCE , janë parashtruar si në vijim:

Ankesa parashtrohet kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 28.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE GRESA COMMERC. Pretendimet e mëposhtme janë të njëjta me ato të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim. Në këtë fazë paraqiten edhe kundërargumentet ndaj arsyetimit me të cilin AK i ka refuzuar ato.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1 – MOSNDARJA E AKTIVITETIT NË LOTE DHE KUFIZIMI I KONKURRENCËS

Autoriteti Kontraktues ka vendosur që furnizimi me dru zjarri dhe furnizimi me pelet të realizohen në kuadër të një loti të vetëm.

OE ankues nuk pretendon se çdo kontratë që përmban kategori të ndryshme mallrash duhet detyrimisht të ndahet në lote. Pretendimi është se diskrecioni i Autoritetit Kontraktues për ta mbajtur aktivitetin në një lot nuk është absolut dhe duhet të ushtrohet në pajtim me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, ekonomicitetit dhe mosdiskriminimit.

Druri i zjarrit dhe peleti janë dy kategori të dallueshme të mallrave. Ato kanë prodhues të ndryshëm, furnitorë të ndryshëm, burime të ndryshme furnizimi, karakteristika të ndryshme teknike, procese të ndryshme prodhimi, mënyra të ndryshme magazinimi dhe treg/strukturë të ndryshme të operatorëve ekonomikë.

Në treg ekzistojnë operatorë ekonomikë të specializuar në furnizimin me dru zjarri dhe operatorë të specializuar në furnizimin ose prodhimin e peletit.

Duke i bashkuar këto dy kategori në një lot, një operator ekonomik që ka kapacitet të plotë për realizimin e furnizimit me dru, por nuk merret me pelet, nuk mund të ofertojë individualisht. E njëjta situatë vlen edhe për një furnizues ose prodhues të peletit që nuk merret me tregtimin e druve.

Arsyetimi i AK-së

AK e arsyeton një kontratë të vetme me një pikë të vetme përgjegjësie kontraktuale, koordinim më të unifikuar, monitorim më efikas, reagim më të shpejtë dhe menaxhim më ekonomik.

OE nuk konteston se këto mund të përbëjnë përfitime administrative. Mirëpo, këto janë arsye të përgjithshme që mund të përdoren praktikisht për çdo aktivitet të ndarë në lote.

Vendimi nuk përmban analizë konkrete që balancon përfitimin administrativ të pretenduar me efektin kufizues mbi konkurrencën.

Pyetja juridike nuk është nëse AK-së i lejohet të përdorë një lot të vetëm. Pyetja është: A ka dëshmuar AK në rrethanat konkrete se përfitimi nga një kontratë e vetme është proporcional me kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve të specializuar?

· analizë të numrit të operatorëve potencialë;
· analizë të ndikimit të mosndarjes në konkurrencë;
· krahasim të mundshëm të çmimeve në rast ndarjeje;
· analizë të kostos administrative të dy loteve;
· ndonjë pengesë teknike që e bën të pamundur ndarjen.

Argumenti i AK-së se operatorët mund të formojnë grup operatorësh ekonomikë ose të përdorin nënkontraktim nuk e eliminon efektin kufizues. Mundësia e formimit të grupit është një e drejtë e OE-së dhe nuk duhet të shndërrohet në domosdoshmëri vetëm që një operator i specializuar të mund të marrë pjesë në procedurë.

Zgjidhja e mundshme

Aktiviteti mund të strukturohet: LOT 1 – Furnizim me dru zjarri; LOT 2 – Furnizim me pelet, duke lejuar që OE të ofertojë për njërin ose për të dy lotet.

Nëse i njëjti operator paraqet ofertën më të favorshme në të dy lotet, ai mund ti fitojë të dy, prandaj ndarja nuk nënkupton domosdoshmërisht që AK do të ketë dy operatorë të ndryshëm. Nëse operatorë të ndryshëm janë më konkurrues për secilin produkt, AK përfiton çmimin më të favorshëm për secilën kategori.

Përfundim për Pretendimin nr. 1: OE kërkon që aktiviteti të ndahet në LOT 1 – Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 – Furnizim me pelet dhe kriteret ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale të përshtaten proporcionalisht për secilin lot. Subsidiarisht, nëse OSHP vlerëson se ndarja në lote nuk është juridikisht e detyrueshme, kërkohet që AK të obligohet të kryejë dhe dokumentojë një analizë konkrete të proporcionalitetit dhe ndikimit në konkurrencë para vazhdimit të procedurës.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – KRITERI JOPROPORCIONAL PËR MJETET TRANSPORTUESE

Dosja e Tenderit kërkon: 1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton.

OE nuk konteston të drejtën e AK-së për të kërkuar që operatori ekonomik të ketë mjete të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Nuk kontestohet as mundësia që AK të përcaktojë një numër minimal mjetesh, nëse ky numër është objektivisht i nevojshëm. Ajo që kontestohet është

imponimi i kufijve maksimalë prej 5 dhe 7 tonësh dhe konfigurimi i ngurtë i flotës pa analizë teknike që provon pse automjetet me kapacitet më të madh janë të papërshtatshme.

Arsyetimi i AK-së

Në Vendimin e datës 28.08.2026, AK e arsyeton kriterin me afatin prej 3 ditësh për furnizim, numrin e institucioneve, lokacionet e ndryshme, urdhërblerjet e mundshme të njëkohshme, vazhdimësinë në rast defekti të ndonjë automjeti dhe nevojën për së paku tri mjete.

Këto argumente mund të shpjegojnë numrin e automjeteve. Por nuk shpjegojnë pse dy automjete duhet të jenë MAKSIMUM 5 ton dhe një automjet MAKSIMUM 7 ton.

Shembulli	**Konfigurimi**	**Kapaciteti total**	**Rezultati sipas kriterit**
OE A	7 t + 5 t + 5 t	17 t	Kalon
OE B	8 t + 6 t + 6 t	20 t	Mund të eliminohet

Efekti: OE B ka kapacitet superior +3 t. Kriteri nuk mat kapacitetin real.

Ky shembull dëshmon se kriteri nuk mat aftësinë reale për realizimin e kontratës. Ai mat vetëm përputhjen me një konfigurim numerik të paracaktuar. Kjo është në kundërshtim me Nenin 51.3 të LPP-së, sipas të cilit kriteret dhe dëshmitë e kërkuara duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Mungesa e bazës teknike

Nëse AK pretendon se kamionët mbi 5 ose 7 ton nuk mund të hyjnë në lokacione të caktuara, kjo duhet të provohet konkretisht. Vendimi nuk identifikon:

· asnjë shkollë konkrete;
· asnjë rrugë konkrete;
· asnjë kufizim tonazhi;
· asnjë oborr ose hyrje me kufizim fizik;
· asnjë urë;
· asnjë dimension;
· asnjë raport teknik;
· asnjë analizë profesionale.

Për këtë arsye kërkohet që OSHP, në kuadër të kompetencave të veta sipas Nenit 105 të LPP-së, ti kërkojë AK-së dokumentacionin mbi të cilin është përcaktuar kufiri "maksimum 5 ton / maksimum 7 ton". Nëse një analizë e tillë nuk ka ekzistuar para publikimit të Dosjes së Tenderit, kriteri nuk duhet të arsyetohet retroaktivisht pas kundërshtimit të OE-së.

Përfundim për Pretendimin nr. 2: Kriteri duhet të largohet në formulimin aktual dhe të zëvendësohet me një kërkesë funksionale, për shembull: "Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, përmes pronësisë, qirasë ose një marrëveshjeje tjetër të ligjshme, mjete transportuese të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e furnizimit brenda afatit kontraktual." Nëse AK kërkon numër ose kapacitet të caktuar minimal/maksimal, ai duhet të mbështetet me analizë objektive dhe teknike.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3 – VLERA E PARASHIKUAR PREJ 200,000.00 EUR NUK REZULTON E ARSYESHME DHE REALE

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar vlerën e parashikuar të aktivitetit në 200,000.00 EUR. Sipas sasive indikative të Dosjes së Tenderit, aktiviteti përfshin rreth 560 ton pelet dhe 192 m³ dru zjarri.

Sipas Nenit 13 të Rregullores Nr. 001/2022, parallogaritja e vlerës së kontratës duhet të jetë e arsyeshme dhe reale, ndërsa AK duhet të marrë parasysh çmimet e tregut, kontratat paraprake dhe analizën e kostos. Gjithashtu, sipas Nenit 16.1 të LPP-së, vlera e parashikuar e kontratës për furnizim duhet të pasqyrojë çmimin përfundimtar të parashikuar që do të paguajë AK dhe elementet relevante të çmimit.

Dy prova konkrete të tregut

Furnitori	Data	Produkti	Sasia	Çmimi pa TVSH	Çmimi me TVSH
GNTC Group SH.A.	15.07.2026	Pelet druri Class A2	1,000 kg	338.98 €	afërsisht 400.00 €/ton
Alfa Globe SHPK	15.07.2026	Pelet druri për ngrohje	52 ton	330.508 €/ton	390.00 €/ton

Oferta e Alfa Globe është veçanërisht relevante sepse është ofertë për 52 ton, pra një furnizim komercial me shumicë dhe jo çmim pakice. Të dy ofertat janë të datës 15.07.2026, vetëm rreth një muaj para publikimit të aktivitetit më 18.08.2026.

Kalkulimi me çmimin më të ulët të dokumentuar

Elementi	Formula	Rezultati
Pelet - me TVSH	560 ton × 390.00 €	218,400.00 €
Tejkalimi vetëm nga peleti	218,400.00 € - 200,000.00 €	18,400.00 €
Pelet - pa TVSH	560 ton × 330.508 €	185,084.48 €
Mbetja nga 200,000 €	200,000.00 € - 185,084.48 €	14,915.52 € për 192 m³ dru + kostot tjera

Pika vendimtare: edhe duke përdorur çmimin më të ulët të dokumentuar, vetëm 560 ton pelet japin 218,400.00 EUR me TVSH, pra 18,400.00 EUR mbi tërë vlerën e parashikuar të aktivitetit, pa përfshirë fare 192 m³ dru zjarri.

Përgjigjja ndaj arsyetimit të AK-së

Arsyetimi i AK-së	Kundërargumenti / prova
“Nuk janë identifikuar furnitorët.”	GNTC Group SH.A. dhe Alfa Globe SHPK identifikohen qartë.
“Nuk është dëshmuar data e çmimeve.”	Të dy ofertat janë të datës 15.07.2026.
“Nuk është dëshmuar furnizimi me shumicë.”	Oferta Alfa Globe është për 52 ton, vlerë totale 20,280.00 EUR.
“Nuk është dëshmuar TVSH-ja.”	Të dy dokumentet paraqesin TVSH 18%.
“Sasitë janë indikative ±30%.”	Devijimi i lejuar nuk e zëvendëson detyrimin që parallogaritja

fillestare të jetë e arsyeshme dhe reale.

Sa i përket transportit dhe kushteve DDP, OE nuk pretendon më shumë se çfarë provojnë dokumentet. Ofertat nuk deklarojnë shprehimisht se çmimi përfshin dorëzimin DDP në secilën shkollë të Gjakovës. Mirëpo, kjo nuk e dobëson pretendimin. Nëse transporti dhe shpërndarja nuk janë të përfshira, ato përbëjnë kosto shtesë dhe nuk mund ta zvogëlojnë vlerën e furnizimit.

Sqarim procedural lidhur me këto prova: Dy ofertat e tregut të bashkëngjitura nuk përbëjnë pretendim të ri ankimor. Ato janë prova shtesë në mbështetje të Pretendimit Ankimor nr. 3, i cili është ngritur shprehimisht në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 25.08.2026.

Kërkesë për verifikim nga OSHP

AK në Vendimin e vet deklaron se ka "rishqyrtuar bazën" e përcaktimit të vlerës së parashikuar. Mirëpo, nuk paraqet metodologjinë konkrete. Për këtë arsye kërkohet që OSHP ti kërkojë AK-së:

· çmimin njësi që ka përdorur për 1 ton pelet;
· çmimin njësi për 1 m³ dru;
· burimet konkrete të tregut;
· datën e hulumtimit të tregut;
· kontratat paraprake të përdorura për krahasim;
· analizën e kostos;
· transportin dhe shpërndarjen;
· dokumentin e parallogaritjes mbi të cilin është prodhuar vlera 200,000.00 EUR.

Përfundim për Pretendimin nr. 3: Ekziston dyshim objektiv dhe i dokumentuar se vlera prej 200,000.00 EUR nuk pasqyron realisht sasitë dhe çmimet aktuale të tregut. Për këtë arsye kërkohet rishqyrtimi i parallogaritjes dhe, nëse nga verifikimi rezulton se vlera nuk është reale, korrigjimi i vlerës së parashikuar dhe planifikimit financiar.

Më poshtë gjeni ofertat e peletit nga dy furnitorë të ndryshëm:

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I VENDIMIT TË AK-së

Vendimi i AK-së nuk i përgjigjet plotësisht thelbit të pretendimeve të OE-së. Në Pretendimin nr. 2, AK arsyeton nevojën për disa mjete transportuese, por nuk arsyeton kufirin maksimal prej 5 dhe 7 tonësh. Në Pretendimin nr. 1, AK paraqet përfitime të përgjithshme administrative nga një kontratë e vetme, por nuk analizon efektin konkret të mosndarjes në konkurrencë. Në Pretendimin nr. 3, AK deklaron se ka rishqyrtuar bazën e vlerës së parashikuar, por nuk bën të verifikueshme metodologjinë dhe dokumentet mbi të cilat është arritur në shumën 200,000.00 EUR.

Kjo pjesë nuk paraqitet si pretendim i ri, por si argument shtesë në mbështetje të tri pretendimeve të ngritura që në fazën e Kërkesës për Rishqyrtim.

EFEKTI PEZULLUES I ANKESËS

Me dorëzimin e kësaj ankese, kërkohet zbatimi i Nenit 112 të LPP-së dhe Nenit 66.1 të Rregullores Nr. 001/2022, lidhur me pezullimin e aktivitetit të prokurimit, për aq kohë sa nuk merret vendim tjetër nga organi kompetent sipas ligjit.

Pergjigje ne kerkesen per rishqyrtim:

Operatori ekonomik N.T.P “GRESA COMMERC”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru dhe pelet", Nr. i prokurimit - 632-26-3785-1-1-1, Nr. i brendshëm - 632-26-022-111.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjakovës, më datë 28.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka vlerësuar si më poshtë:

• **PRETENDIMIT NR. 1 – Mosndarja e aktivitetit në lote**

Operatori Ekonomik pretendon se furnizimi me dru dhe furnizimi me pelet duhet të ndahen në dy lote të veçanta, me arsyetimin se bëhet fjalë për produkte me prodhues, furnitorë dhe procese të ndryshme furnizimi. Operatori kërkon që aktiviteti të ndahet në LOT 1 - Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 - Furnizim me pelet.

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me këtë pretendim.

Objekti i aktivitetit të prokurimit është sigurimi i energjentëve për ngrohjen e institucioneve arsimore të Komunës së Gjakovës. Edhe pse druri dhe peleti kanë karakteristika teknike të ndryshme, të dy produktet i shërbejnë të njëjtit qëllim funksional dhe administrativ, përkatësisht sigurimit të ngrohjes së objekteve shkollore gjatë sezonit të ngrohjes.

Aktiviteti është konceptuar si kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, me kohëzgjatje prej 10 muajsh. Furnizimet realizohen vetëm pas lëshimit të urdhërblerjeve nga Autoriteti Kontraktues, sipas nevojave faktike të institucioneve arsimore, ndërsa vendi i dorëzimit është në shkollat e Komunës së Gjakovës dhe kushtet e dorëzimit janë DDP.

Duke marrë parasysh mënyrën e realizimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se administrimi përmes një kontrate të vetme siguron:

- një pikë të vetme të përgjegjësisë kontraktuale;
- koordinim të unifikuar të urdhërblerjeve dhe dërgesave;
- monitorim më efikas të realizimit të kontratës;
- reagim më të shpejtë ndaj nevojave të institucioneve arsimore;
- shmangie të paqartësive lidhur me përgjegjësinë në rast të vonesave ose mungesës së furnizimit;
- menaxhim më ekonomik dhe më efikas të kontratës.

Ndarja e një kontrate në lote përbën një mundësi të Autoritetit Kontraktues dhe jo obligim automatik. Neni 13.2 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se kontratat që përmbajnë mallra homogjene ose heterogjene mund të ndahen në lote, veçanërisht kur kjo vlerësohet e nevojshme për inkurajimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose për zgjerimin e konkurrencës. Dispozita nuk e obligon Autoritetin Kontraktues që çdo furnizim me më shumë se një kategori mallrash ta ndajë domosdoshmërisht në lote.

Dosja e Tenderit nuk kërkon që Operatori Ekonomik të jetë vetë prodhues i drurit dhe i peletit. Kërkohet që operatori të ketë aftësi për sigurimin dhe dorëzimin e produkteve sipas specifikimeve teknike dhe kushteve kontraktuale. Prandaj, operatorët mund ti sigurojnë produktet nga burime të ndryshme të ligjshme të furnizimit.

Përveç pjesëmarrjes individuale, Dosja e Tenderit lejon pjesëmarrjen si grup i operatorëve ekonomikë dhe deklarimin e nënkontraktimit, duke ofruar mundësi shtesë që operatorët e specializuar të bashkëpunojnë për realizimin e kontratës. Kjo mundësi paraqet argument plotësues dhe jo arsyen kryesore për mosndarjen e aktivitetit në lote.

Strukturimi në një lot zbatohet njësoj ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe nuk përmban kërkesë që favorizon një operator, prodhues, markë apo burim të caktuar furnizimi.

Nga aspekti teknik, funksional dhe organizativ, Autoriteti Kontraktues vlerëson se strukturimi i aktivitetit në një lot të vetëm është i lidhur drejtpërdrejt me nevojat konkrete të furnizimit të institucioneve arsimore dhe me mënyrën e administrimit të kontratës publike kornizë.

Kështu që, pretendimi nr. 1 refuzohet si i pabazuar.

• **PRETENDIMI NR. 2 - Kriteri lidhur me mjetet transportuese**

Operatori Ekonomik kundërshton kërkesën për disponimin e:

- një kamioni me peshë ngarkuese maksimum 7 tonë; dhe
- dy kamionëve me peshë ngarkuese maksimum 5 tonë.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik, vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe, si i tillë, refuzohet.

Kontrata në fjalë përfshin furnizimin e disa institucioneve arsimore të Komunës së Gjakovës, sipas urdhërblerjeve që mund të lëshohen gjatë gjithë periudhës 10-mujore të kontratës. Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, furnizimet duhet të realizohen brenda tri ditëve nga pranimi i urdhërblerjes dhe gjatë orarit të punës së Autoritetit Kontraktues.

Duke marrë parasysh natyrën e furnizimit, numrin e institucioneve përfituese, lokacionet e ndryshme ku duhet të realizohen dërgesat, si dhe afatin e shkurtër për realizimin e tyre, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se disponimi i së paku tri mjeteve transportuese është i nevojshëm për sigurimin e realizimit efikas dhe në kohë të kontratës.

Kërkesa për mjete transportuese është përcaktuar duke u bazuar në nevojat reale operative të Autoritetit Kontraktues dhe synon, ndër të tjera:

- realizimin e furnizimeve brenda afatit kontraktual prej tri ditësh;
- mundësinë e realizimit të furnizimeve në disa institucione arsimore dhe lokacione të ndryshme;
- sigurimin e kapacitetit të nevojshëm transportues në rast të urdhërblerjeve të njëkohshme ose të afërta në kohë;
- garantimin e vazhdimësisë së furnizimit në rast të defektit, mirëmbajtjes apo ndonjë pengese tjetër që mund të paraqitet në njërin prej mjeteve;
- sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm për transportimin dhe shpërndarjen e drurit dhe peletit, sipas sasive dhe kërkesave të institucioneve përfituese;
- parandalimin e vonesave në furnizim, të cilat mund të cenojnë funksionimin e sistemeve të ngrohjes në institucionet arsimore.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa për së paku tri mjete transportuese nuk është e përcaktuar në mënyrë arbitrare, por lidhet drejtpërdrejt me objektin, mënyrën dhe afatet e realizimit të kontratës.

Gjithashtu, kriteri nuk kufizon operatorët ekonomikë në një markë, prodhues, model, vit prodhimi apo origjinë të caktuar të mjeteve. Operatorët ekonomikë nuk janë të detyruar që mjetet ti kenë në pronësi, pasi disponueshmëria e tyre mund të dëshmohet përmes pronësisë, qirasë apo një marrëveshjeje tjetër të ligjshme për shfrytëzim. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kriteri nuk paraqet kufizim të pajustifikuar të konkurrencës.

Andaj, nevoja për së paku tri mjete transportuese, një kamioni me peshë ngarkuese maksimum 7 tonë dhe dy kamionëve me peshë ngarkuese maksimum 5 tonë mbetet e arsyeshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin, numrin e lokacioneve dhe afatin e realizimit të furnizimeve.

• PRETENDIMI NR. 3 - Vlera e parashikuar e kontratës

Operatori Ekonomik pretendon se vlera e parashikuar prej 200,000.00 € nuk është e arsyeshme dhe reale.

Në mbështetje të pretendimit, Operatori Ekonomik ka përdorur çmimin orientues prej rreth 400.00 € për ton pelet dhe 70.00-75.00 € për metër kub dru, duke llogaritur një vlerë të përgjithshme prej rreth 237,440.00 € deri në 238,400.00 €. Autoriteti Kontraktues ka rishqyrtuar bazën e përcaktimit të vlerës së parashikuar dhe konsideron se pretendimi i Operatorit Ekonomik nuk është mbështetur me dëshmi të mjaftueshme dhe të verifikueshme për të provuar se vlera e parashikuar është përcaktuar në kundërshtim me legjislacionin.

Vlera e parashikuar e aktivitetit është përcaktuar para inicimit të procedurës, në kuadër të planifikimit të nevojave, paramasës, parallogarisë, konsumit të planifikuar dhe dokumentacionit të brendshëm të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues është i vetëdijshëm se, sipas nenit 13.1 dhe 13.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, parallogaritja duhet të jetë e arsyeshme dhe reale dhe duhet të marrë parasysh çmimet e tregut, kontratat paraprake kur ato ekzistojnë dhe analizën e kostos së specifikimeve relevante.

Megjithatë, llogaritja e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk përbën vetvetiu hulumtim të plotë dhe të krahasueshëm të tregut, sepse:

1. nuk janë identifikuar qartë furnitorët ose burimet e çmimeve të përdorura;
2. nuk është dëshmuar data dhe periudha e vlefshmërisë së çmimeve;
3. nuk është dëshmuar se çmimet i referohen sasive të njëjta dhe furnizimit me shumicë;
4. nuk është dëshmuar në mënyrë të verifikueshme se çmimet përfshijnë specifikimet teknike të tenderit, TVSH-në, transportin dhe të gjitha kushtet DDP;
5. nuk është paraqitur një krahasim me kontrata paraprake të ngjashme të Autoritetit Kontraktues ose autoriteteve të tjera;
6. llogaritja është bërë duke shumëzuar 100% të sasive indikative me çmime orientuese të përcaktuara nga vetë Operatori Ekonomik.

Vetë Operatori Ekonomik deklaron se çmimet do të mbështeten me dëshmi ose oferta, mirëpo në kërkesën e shqyrtuar nuk janë evidentuar oferta konkrete krahasuese që mundësojnë verifikimin

e çmimeve të pretenduara. Aktiviteti është kontratë publike kornizë dhe furnizimet do të realizohen përmes urdhërblerjeve, sipas nevojave faktike gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Dosja e Tenderit përcakton shprehimisht se sasitë janë indikative dhe se devijimi i lejuar është ±30%.

Edhe Rregullorja për Prokurimin Publik përcakton se sasitë e kontratave publike kornizë janë indikative, se mund të lejohet devijimi deri në ±30% dhe se pagesa bëhet vetëm për furnizimet e porositura dhe të pranuara.

Për rrjedhojë, shumëzimi i të gjitha sasive indikative me çmime orientuese të paargumentuara nuk është dëshmi e mjaftueshme se vlera e parashikuar e aktivitetit është e paarsyeshme ose joreale.

Vlera e parashikuar nuk duhet të përcaktohet sipas vlerësimit individual të një operatori ekonomik, por sipas një parallogaritjeje të Autoritetit Kontraktues të mbështetur në dokumentacionin e planifikimit, hulumtimin e tregut dhe nevojat e parashikuara për periudhën përkatëse.

Në mungesë të dëshmive konkrete, të krahasueshme dhe të verifikueshme që e rrëzojnë parallogaritjen e Autoritetit Kontraktues, konsideron se nuk ekziston bazë e mjaftueshme për ndryshimin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në këtë aspekt, pretendimi nr. 3 refuzohet si i pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08.09.2026 ka autorizuar ekspertin/teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0683/2026, ndërsa me datë 18.09.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2026/0683 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit..

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit shyrtues ndërsa OE nuk pergjigjet rreth raportit te ekspertit shyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.P.GRESA - COMMERCE , eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0683 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor nr. 1

Pretendimi ankimor i OE ankues lidhur me kërkesën për ndarjen e aktivitetit të prokurimit në dy lote, përkatësisht LOT 1 – Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 – Furnizim me pelet, vlerësohet si i pabazuar.

Eksperti shqyrtues vlerson se fakti se aktiviteti I prokurimit përfshin dy kategori të ndryshme mallrash nuk nënkupton në mënyrë automatike detyrimin e Autoritetit Kontraktues për ndarjen e aktivitetit në lote. Përcaktimi i mënyrës së strukturimit të aktivitetit të prokurimit është pjesë e përgjegjësisë së AK-së, i cili, duke marrë parasysh nevojat konkrete të tij, mund të përcaktojë realizimin e furnizimeve përmes një kontrate të vetme, për sa kohë që kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje me parimet dhe rregullat e prokurimit publik.

Eksperti shqyrtues vlerson se në rastin konkret, AK ka arsyetuar bashkimin e furnizimit me dru zjarri dhe pelet në një lot me nevojën për një pikë të vetme përgjegjësie kontraktuale, koordinim dhe monitorim më efikas, reagim më të shpejtë dhe menaxhim më të unifikuar të kontratës..

Eksperti shqyrtues vlerëson gjithashtu, pretendimi se bashkimi i këtyre furnizimeve domosdoshmërisht kufizon konkurrencën nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar shkelje. Vetë mundësia që disa operatorë ekonomikë të jenë të specializuar vetëm në njërën kategori nuk dëshmon se kushtet e përcaktuara nga AK janë diskriminuese apo joproporcionale. Operatorët ekonomikë kanë mundësinë të marrin pjesë individualisht ose në grup me operatorë të tjerëekonomikë, në pajtim me rregullat e aplikueshme të prokurimit.

Sa i përket kërkesës së OE ankues që AK të detyrohet të ndajë aktivitetin në lote, një kërkesë e tillë nuk mund të pranohet vetëm mbi bazën e argumentit se ndarja në lote do të mundësonte pjesëmarrjen e operatorëve të specializuar. Ndarja në lote është një mundësi për strukturimin e aktivitetit të prokurimit dhe jo një e drejtë e operatorit ekonomik për të imponuar mënyrën e organizimit të kontratës nga AK.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pas shqyrtimit të pretendimit dhe arsyetimit të AK-së, nuk është konstatuar se vendimi për realizimin e furnizimit me dru zjarri dhe pelet në kuadër të një loti të vetëm, në vetvete, cenon parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, ekonomicitetit apo mosdiskriminimit. OE ankues nuk ka paraqitur prova konkrete që dëshmojnë se struktura e përcaktuar nga AK ka krijuar një pengesë të pajustifikuar ose diskriminuese për pjesëmarrjen në procedurë.

Prandaj, Pretendimi Ankimor nr. 1 i OE ankues rekomandohet të refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor nr. 2

Pretendimi ankimor lidhur me kërkesën e Dosjes së Tenderit për mjetet transportuese, përkatësisht 1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton, nuk trajtohet në këtë ekspertizë, pasi e njëjta çështje është trajtuar dhe vlerësuar më parë në Ekspertizën nr. 2026/0466 dhe është vendosur me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0466.

Meqenëse pretendimi aktual lidhet me të njëjtën kërkesë të Dosjes së Tenderit dhe me të njëjtën çështje që tashmë është objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organi kompetent, nuk ekziston bazë për rishqyrtim të së njëjtës çështje në kuadër të kësaj procedure.

Prandaj, pretendimi ankimor nr. 2 nuk trajtohet në substancë, pasi çështja për të cilën parashtrohet ky pretendim është trajtuar më parë në Ekspertizën nr. 2026/0466 dhe është vendosur me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0466.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor nr. 3

Vlerësimi i Pretendimit Ankimor nr. 3 – Lidhur me vlerën e parashikuar të kontratës

Pretendimi i OE ankues se vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit prej 200,000.00 EUR nuk është reale dhe nuk pasqyron çmimet aktuale të tregut, nuk mund të pranohet si i bazuar, për arsyet në vijim.

Së pari, duhet bërë dallimi ndërmjet vlerës së parashikuar të kontratës, e cila përcaktohet nga Autoriteti Kontraktues mbi bazën e një parallogaritjeje të arsyeshme dhe të dokumentuar, dhe çmimeve individuale të ofertave ose ofertave indikative të siguruara nga operatorë ekonomikë të caktuar. Fakti se OE ankues ka siguruar dy oferta të datës 15.07.2026 nuk e provon, në vetvete, se këto çmime përfaqësojnë çmimin relevant të tregut për objektin konkret të prokurimit.

Dy ofertat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të provuar pasaktësinë e vlerës së parashikuar

OE ankues mbështetet kryesisht në dy dokumente të datës 15.07.2026, përkatësisht ofertën e GNTC Group SH.A. dhe ofertën e Alfa Globe SHPK.

Eksperti shqyrtues vlerëson se , një çmim i marrë nga një ofertë individuale tregtare nuk mund të merret automatikisht si bazë detyruese për përcaktimin e vlerës së parashikuar të një aktiviteti tjetër prokurimi, pa u vërtetuar krahasueshmëria e plotë e kushteve. Kalkulimi aritmetik i OE-së nuk provon se vlera e parashikuar është e paligjshme

OE pretendon se 560 ton pelet, me çmimin 390.00 EUR/ton me TVSH, rezultojnë në vlerën 218,400.00 EUR dhe, për këtë arsye, tejkalojnë vlerën e parashikuar prej 200,000.00 EUR.

Ky kalkulim, si veprim matematikor, mund të jetë i saktë, por përfundimi juridik i nxjerrë prej tij nuk është i qëndrueshëm.

Vlera e parashikuar e kontratës nuk përcaktohet duke shumëzuar në mënyrë mekanike një sasi indikative me çmimin e një oferte të vetme të tregut. Parallogaritja duhet të bazohet në vlerësimin e përgjithshëm të nevojës, karakteristikave të furnizimit, kushteve të tregut dhe elementeve të çmimit që lidhen me kontratën konkrete.

Për më tepër, vetë OE pranon se sasitë e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë indikative dhe i nënshtrohen tolerancës së përcaktuar në dokumentet e tenderit. Prandaj, përdorimi i sasisë 560 ton si një detyrim absolut i AK-së dhe nxjerrja e përfundimit se vlera e parashikuar duhet domosdoshmërisht të jetë mbi një prag të caktuar, nuk është i drejtë.

. Çmimi i ofertës së Alfa Globe nuk mund të konsiderohet automatikisht si çmim referues për tërë aktivitetin

OE i jep peshë të veçantë ofertës së Alfa Globe SHPK për 52 ton, me çmim 390.00 EUR/ton me TVSH.

Megjithatë, fakti që oferta është për 52 ton nuk e bën atë automatikisht përfaqësuese të çmimit për një aktivitet me sasi indikative prej rreth 560 ton pelet dhe 192 m³ dru zjarri.

OE nuk ka dëshmuar në mënyrë bindëse ekuivalencën e këtyre kushteve.

Prandaj, kjo ofertë mund të konsiderohet një indikator i tregut, por jo si provë përfundimtare se parallogaritja e AK-së është e pasaktë ose e kundërligjshme.

OE përdor çmimin prej 390.00 EUR/ton me TVSH dhe e krahason drejtpërdrejt rezultatin prej 218,400.00 EUR me vlerën e parashikuar prej 200,000.00 EUR.

Një ofertë për një sasi të caktuar dhe në kushte të caktuara nuk mund të ekstrapolohet automatikisht në një kontratë publike me karakteristika të ndryshme.

Po ashtu, ekzistenca e një çmimi të caktuar në treg nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar ta përdorë pikërisht atë çmim në parallogaritjen e tij. Për të vërtetuar të kundërtën, OE duhet të dëshmojë se metoda e përdorur nga AK është objektivisht e pabazuar, joreale ose në kundërshtim me kërkesat ligjore, dhe jo vetëm se ekzistojnë oferta të tjera me çmime të ndryshme.

.Pretendimi i OE-së se dy ofertat e datës 15.07.2026 janë prova shtesë në mbështetje të Pretendimit Ankimor nr. 3 mund të merret në konsideratë si argument mbështetës. Megjithatë, këto dokumente nuk mund të trajtohen si provë përfundimtare se AK ka shkelur detyrimin ligjor për përcaktimin e vlerës së parashikuar. Vlerësimi duhet të bëhet mbi bazën e të gjithë dokumentacionit të parallogaritjes së përgatitur nga AK, metodologjisë së përdorur dhe kushteve konkrete të aktivitetit.Ekzistenca e dy ofertave të tregut nuk e zhvendos barrën e vërtetimit në atë mënyrë që çdo dallim ndërmjet këtyre ofertave dhe vlerës së parashikuar të konsiderohet automatikisht si shkelje ligjore.

Në bazë të sa më sipër, vlerësohet se OE ankues nuk ka arritur të dëshmojë me prova të mjaftueshme se vlera e parashikuar prej 200,000.00 EUR është përcaktuar në mënyrë joreale, arbitrare apo në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme të legjislacionit të prokurimit publik.

Dy ofertat e paraqitura nga OE dëshmojnë vetëm ekzistencën e disa çmimeve të caktuara në treg në një datë të caktuar. Ato nuk dëshmojnë, në mënyrë të mjaftueshme, se këto çmime janë plotësisht të krahasueshme me objektin konkret të prokurimit dhe as se metodologjia e përdorur nga AK për përcaktimin e vlerës së parashikuar ka qenë e gabuar.

Për rrjedhojë, Pretendimi Ankimor nr. 3 duhet të refuzohet si i pabazuar, pasi provat e paraqitura nga OE nuk janë të mjaftueshme për të konstatuar shkelje të dispozitave të prokurimit publik lidhur me përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Fakti që një operator ekonomik mund të sigurojë një ofertë të caktuar në treg, madje edhe një ofertë me çmim më të lartë se parametrat e përdorur nga AK, nuk është në vetvete dëshmi se parallogaritja e AK-së është e paligjshme.

Pretendimi eshte i pa bazuar

Eksperti shqyrtues sqaron për Panelin shqyrtues se kjo ankes është bërë më 07.09.2026 në OSHP.

Kërkesa Për Rishqyrtim në AK më 25.08.2026

AK-ja ka bërë zgjatje të afatit për dorëzimin e ofertave duke përdorur Formularin B54 pra më date 18.08.2026 në e-prokurim dhe sërish zgjatje më 28.08.2026.

B05 Njoftim per Kontrat

20.05.2026 15:07

Kodi i dokumentit: 2026/632-26-3785-1-1-1/B05-0009608

Hape:

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

17.06.2026 13:54

Kodi i dokumentit: 2026/632-26-3785-1-1-1/B54-0012154

Hape:

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

26.06.2026 14:12

Kodi i dokumentit: 2026/632-26-3785-1-1-1/B54-0013007

Hape:

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

18.08.2026 10:29

Kodi i dokumentit: 2026/632-26-3785-1-1-1/B54-0017542

Hape:

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

28.08.2026 11:38

Kodi i dokumentit: 2026/632-26-3785-1-1-1/B54-0018535

Duke pasur parasysh që Kërkesa Për Rishqyrtim është bërë më 25.08.2026 pas zgjatjes së afatit për Rishqyrtim eksperti shqyrtues vlerson se kjo ankesë mund të trajtohet edhe konform nenit 60 I Rregullores Për Prokurim Publik:

Megjithatë Eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore konform kompetencave të tij.

Neni 60.Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik,

funksioni “ kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kerkeses per rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjeserisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara kjo duke u mbeshtet ne vendimin paraprak 2026/0466 , ku korigjimi i procedures nga vendimi paraprak AK ka bërë vetem për hapje të ofertave .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur qe AK te lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me dru dhe pelet me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E GJAKOVËS**
- OE - **N.T.P."GRESA - COMMERCE "**
- Arkivës së OSHP-së: